VENDIM
Nr.357, datë 24.4.2013

PËR MIRATIMIN E RREGULLORES "PËR MENAXHIMIN E DOKUMENTIT ELEKTRONIK NË REPUBLIKËN E SHQIPËRISË"

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të pikës 3 të nenit 21 të ligjit nr. 10 273, datë 29.4.2010 "Për dokumentin elektronik" dhe të ligjit nr. 9880, datë 25.2.2008 "Për nënshkrimin elektronik", me propozimin e Ministrit për Inovacionin dhe Teknologjinë e Informacionit e të Komunikimit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Miratimin e rregullores "Për menaxhimin e dokumentit elektronik në Republikën e Shqipërisë", sipas tekstit që i bashkëlidhet këtij vendimi.
2. Ngarkohen të gjitha njësitë e administratës publike, të cilat do të përdorin dokumentin elektronik për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha